REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

RAPORT

PËR REZULTATET E KONSULTIMIT PUBLIK TË PROJEKTLIGJIT

"PËR LIRIMIN E FREKUENCAVE TË DIGJITAL DIVIDENT DY (DD2)"

1. Titulli i projekt aktit

"Për lirimin e frekuencave të digjital divident dy (DD2".

Projektligji ka si qëllim të sigurojë vazhdimësinë e marrjes nga publiku të të gjitha programeve televizive, që transmetohen nëpërmjet rrjeteve tokësore, pas lirimit të brezit 700 MHz, përmes kompensimit të pjesshëm të kostove neto shtesë/direkte që shkakton procesi i lirimit të brezit 700 MHz.

Lirimi i frekuencave të brezit 700 MHz nga transmetimet audio vizive dhe kalimi i tij për përdorime për rrjetet e komunikimeve elektronike të lëvizshme broad band ka si qëllim zbatimin e Vendimit të Bashkimit Evropian për brezin UHF, Vendimi (EU) 2017/899 i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit i datës 17 Maj 2017, mbi përdorimin e brezit të frekuencave 470-790 MHz në Bashkimin Evropian. Zbatimi i Vendimit të BE për brezin UHF është kërkesë në kuadër të integrimit në Bashkimin Evropian, e përcaktuar në dokumentin e pozicionit të përbashkët negociues për Grup kapitullin e tretë, në lidhje me kërkesat për Kapitullin 10, "Transformimi Digjital dhe Media".

Tjetër qëllim është të krijojë kushtet për lirimin e Digjital Dividentit Dy (DD2), që përdoret aktualisht për transmetime audio vizive dhe vënien e frekuencave të tij në përdorim të rrjeteve të komunikimeve elektronike të lëvizshme, rrjetet 5G sipas legjislacionit në fuqi për komunikimet elektronike dhe të përcaktojë masën e kompensimit financiar, mënyrën e krijimit të saj, kategoritë që përfitojnë, mënyrën e kompensimit, procedurën e administrimit dhe të pagesave. Gjithashtu

me lirimin e frekuencave të brezit 700 MHz nga transmetimet audio vizive synohet zgjidhja e problemit të interferencave me vendet fqinje.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Ky projektligj është publikuar në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (në nivel eksperti dhe qytetari) në datë 11 Shtator 2025 deri në 10 Tetor 2025, për një periudhë 20 ditë pune, në respektim të afatit ligjor të konsultimit.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese…, dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre.
Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë.
Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin "Për lirimin e frekuencave të digjital divident dy (DD2", ishin:

1. Nëpërmjet publikimit në Regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike nga data 11 Shtator 2025 deri në 10 Tetor 2025;
2. Nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në datë 11 Shtator 2025 deri në 10 Tetor 2025;
3. Ndërmjet postës elektronike të koordinatorit për njoftim dhe konsultim publik: vilma.davidhi@infrastruktura.gov.al.

Nga operatorët e rrjetit të transmetimeve numerike televizive u paraqitën komente, kundërshtime për draftin të cilat konsistonin kryesisht për kostot dhe në nevojën e rivlerësimit të vlerës së kompensimit. Pas procesit të konsultimit të projektligjit, AMA në periudhën Janar–Shkurt 2026, angazhoi një ekspert të huaj të përfshirë më parë në projektin e asistencës teknike të Bashkimit Europian, i cili kreu analizën dhe vlerësimin e impaktit në strategjinë e migrimit në DD2 dhe kostot e procesit të kompensimit, bazuar në metodologjinë e mëparshme nga

konsulentët e Bashkimit Europian, si rezultat i ndryshimeve të ndodhura nga viti 2022. Pas këtij procesi vlera e kompensimit është përditesuar me vlerat e reja të kompensimit.

Më pas është vijuar me urdhrin e KM nr. 69 datë 3.4.2026, që riaktivizoi Grupin Ndërinstitucional të Punës si dhe sekretariatin teknik për vijimin e procesit. Grupi Ndërinstitucional i Punës u mblodh për herë të parë në datë 11.5.2026. Më pas u vijua me disa takime të Sekretariatik teknik dhe takimet u përmbyllën në datë 6.7.2026 me prezantimin në Grupin Ndërinstitucional të Punës të draftit final të projektligjit nga sekretariati teknik.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.
Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.
Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Projektligji është përgatitur bazuar në rezultatet e asistencës teknike të Bashkimit Evropian, në kuadër të projektit Technical Assistance for The Telecommunications Sector, si dhe bazuar në urdhrin e KM nr. 113 datë 20.7.2022 "Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për lirimin e Digital Divident Dy".

Palët e interesuara, të cilat morën pjesë në hartimin e këtij projektakti janë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me Autoritetin e Mediave Audiovizive dhe Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Autoriteti Mediave Audiovizive AMA, si autoriteti rregullator në fushën e medias audiovizive do të mbikqyrë gjithë procesim e lirimit të brezit 700 MHZ, koordinimin e gjithë prosecin me operatorët e transmetimeve numerike për lirimin mbi bazë allotmentesh të frekuencave sipas strategjisë së migrimit. AMA do të bashkëpunojë me institucionet e tjera si Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe AKEP në këtë proces.

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, AKEP, do të bashkëpunojë me AMA gjatë procesit të lirimit të frekuencve si dhe në përfundim të procesit të lirimit të brezit 700 MHz do të administrojë këtë brez për ofrimin e shërbimit të

rrjeteve 5G. Licesnimi i ketij brezi për rrjetet 5G do të sigurojë të ardhura për buxhetin e shtetit.

Ministria e Financave është palë e interesuar, pasi ajo do të kontrubuojë me komensimin për operatorët. Vlen të theksohet se mbas procesit te lirimit te rezit 700 MHz ky frez do te administrohet nga AKEP dhe do te jepet per licensimet e rrjeteve 5G në një proces ku pritet të përfitohet më shumë sesa vlera e kompensimit për operatorët televizivë.

Ndërkohë që nga ky proces preken dhe qytetarët që janë marresit e shërbimeve te transmetimeve audiovizive të cilë mund të kenë nderprerje afatshkurtra me marrjen e sinjalit televiziv.

Gjithashtu edhe operatorët e transmetimeve televizive numerike kombëtare private (KLAN, TOP Channel, Digitald, ADTN dhe Vizion Plus) që kanë në përdorim frekuenca të brezit të DD2 si dhe RTSH impaktohen nga lirimi i këtij brezi, pasi do të angazhohen në zbatimin e strategjisë së migrimit si dhe në kryejen e rikonfigurimit të rrjeteve, pajisjeve etj.

Në përfundim, lirimi i këtij brezi do të sjellë impakt pozitiv edhe për vendet fqinje si: Italia, Greqia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Kroacia, pasi do të zgjidhin problemin me interferencat me vendet fqinje dhe do të çoje në uljen e ankesave të tyre.

5. Pasqyra e komenteve të pranuara me arsyetimin e komenteve të pranuara/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimit e pranuara sipas çështjes që ato ngritën;
Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;
Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Projektligji "Për lirimin e frekuencave të digjital divident dy (DD2", ka pasur 560 lexime nga qytetarët dhe 500 nga ekspertët, gjatë publikimit si dhe 11 komente nga operatorët e transmetimeve televizive numerike kombëtare, nga të cilat 3 (tre) komente janë refuzuar, pasi komentet lidheshin me ndërhyrje jashtë kompetencës së institucioneve të qeverisjes qëndrore.

Pasqyra e komenteve paraqitet në tabelën më poshtë:

Nr.	Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi (I	Justifikimi

				pranuar/I pranuar pjesërisht /I refuzuar)	
1.	Komente rreth kompensim të plotë të kostove	Neni 1: Kërkohet kompensim i plote i te gjitha kostove. Lidhur me mbulimin e kostove ka mjaftushem argumentë ligjore, teknike dhe financiarë që duhen marrë parasysh. Ky është një aksion që nuk po e ndërrmerr vetë Digit-Alb/TopChannel /ADTN me iniciativë të vet.	Digitalb & Top Channel & ADTN	I refuzuar	Ligji parashikon vetëm kompensim të pjesshëm të kostove sic është vepruar edhe në vendet e tjera të BE
2.	Komente në lidhje me disa saktësime të termave në projekt ligj	Kërkuar të shtohet pjesa "e brezit të frekuencave" në nenin 1, të shtohet fjala e "ndryshuar" në nenin 3 dhe nenin 7	Top Channel & Digitalb	I pranuar	Saktësimet dhe sugjerimet e dhëna janë pranuar dhe reflektuar në projekt ligj.
3.	Komente në lidhje me kostot e kompensimit	Neni 4: Kërkohet që të mbulohen kostot operacionale si dhe kostot për ngritjen e pikave të reja të transmetimit si	TopChannel & Digitalb & ADTN	I pranuar pjesërisht	Mbulimi i kostove është vetëm për investimet e kryera dhe kostot operaciona

		rrjedhojë e zgjerimit të allotmenteve.			le, por jo për ngritjen e pikave të reja të transmetimit, kështu që pranohet pjesërisht.
4.	Komente në lidhje me kompensimin financiar	Neni 5: Kërkohet të parashikohet edhe problematika që do të na duhet të ndjekim, pasi do të duhet të kompensojmë klientë në një përqindje të caktuar, bazuar edhe në eksperiencat e mëparshme me këto lloj procesesh.	Top Channel & Digitalb	I refuzuar	Nuk pranohet si koment, pasi kjo gjë nuk ka qene e parashikuar edhe për rastin e DD1.
5.	Komente në lidhje me mënyrën e kompensimit	Neni 5: Vlera është përcaktuar në monedhën euro dhe vlerësimi është kryer në vitin 2022 pra tre vjet më përpara. Që nga ajo kohë kemi një zhvlerësim të monedhës Euro në raport me monedhën lekë dhe për rrjedhojë duhet që vlera të	Top Channel & Digitalb KLAN TV	I pranuar pjesërisht	Mbas komenteve të marra nga operatorët, AMA me anë të shkresës nr. 731 datë 24.2.2026, ka përcjellë vlerat e reja të kompensi

		jetë më e madhe në raport të drejtë me normën e zhvlerësimit. Vlera e llogaritur nuk është në përputhje dhe kostot reale, pra është vlerë shume e ulët në raport me kostot që do të ketë subjekti ynë nga ky proces, për më tepër që vlera dhe kostot e pajisjeve teknike rezultojnë se janë rritur.			mit mbas procesit të rivleresimit të kryer nga konsulenti në periudhën Janar – Shkurt 2026 duke marrë në konsideratë shqetësimet e operatorëve. Vlera e kompensimit ka ndryshuar duke marrë në konsideratë shumicën e komentevetë operatorëve. Shuma e re e kompensimit do të jete 6,432,500 Euro.
6.	Komente në lidhje me mënyrën e kompensimit	Neni 5: 1.përllogaritja e kostos është tërësisht e pasaktë (letra	KLAN TV	I pranuar pjesërisht	Pas komenteve të marra nga operatoret,

		prot. 6825 dt. 6.10.2025); vlerësuesit kanë llogaritur se pajisjet tona mund të shiten me cmim të lire po kjo eshte marrezi, pasi keto pajisje nuk mund te perdoren ne Shqiperi, nuk mund te shiten askund tjeter pasi ne jemi vendi I fundit ne Europe qe po lirojme kete brez; nese ata eksperte, AMA apo ministria juaj I shet dot, ne jemi te gatshem tua falim. Llogaritja si te te ardhura te mundshme nga shitja e pajisjeve ekzistuese eshte e pasakte 2. vleresimi eshte bere rreth tre vjet me pare dhe vlera e caktuar eshte ne Euro, nderkohe vlera e Euros aktualisht eshte rreth 30% me pak ne raport me lekun, krahasuar			AMA me anë të shkresës 731 datë 24.2.2026 ka përcjellë vlerat e reja të kompensimit mbas procesit të rivlerësimit të kryer nga konsulenti ne periudhen Janar – Shkurt 2026 duke marr ne konsiderate shqetesimet e operatorve. Vlera e kompensimit ka ndryshuar duke marrë në konsiderate shumicen e komenteve te operatorve. Shuma e re e kompensi

		me periudhen e vleresimit 3.Cmimet e blerjes se transmetuesave jane rritur mbi 20%, krahasuar me cmimet e periudhes se vleresimit; 4.cmimet per montimin instalimin, riberjen e te gjithe rrjetit te ri jane rritur 25% krahasuar me periudhen e vleresimit 5. Prej periudhes kur eshte bere vleresimi I demit, te cilit I refeohet projektlgji, ne kemi shtuar dhe stacione te reja, te cilat kane sjelle rritjen e investimeve tona ne rrjet, e si rezultat eshte rritur dhe vlera e demit qe shkaktohet I cili nuk reflektohet tek ky vleresim; Per te gjitha me sipe, deklarojme se vlera e parashikuar ne projektligj per kompensimin e			mit do të jetë 6,432,500 Euro.

		ben te pamundur lirimin e ketij brezi nga ana jone.. Nga perllogaritjet e bera nga specialistet e Klan TV minimumi I mases se kompensimit per ta, duhet te jete 1.7 milion Euro. Sugjerohet ngritja e nje komisioni me specialise te pavarur te fushes nga AMA - per te bere vleresimin me kushtet dhe cmimet e sotme; (Per me shume referohu shkresa e plote e Klan TV bashkelidhur)			
7.	Komente ne lidhje me menyren e pageses se rimbursimit	Neni 5 &6&7: Kërkohet qe pagesa te behet e plote ne fillim te procesit te lirimit te brezit 700 MHz.	Top Channel & Digitalb	I refuzuar	Nuk është pranuar si koment pasi nese parate jepen ne avance mund te sjellin vonesa ne proces.
8.	Komente në lidhje me kohën e	Neni 6: Kerkohet qe te kihet parasysh se	Top Channel &	I pranuar pjesërisht	Eshtë shtuar një pike ne

	lirimit të brezit.	sot pajisjet e reja kerkojne shume kohe te prodhohen. Pervec rritjes rreth 30% te kostot se prodhimit te pajisjeve, koha e levrimit ka shkuar ne minimalisht 18-22 jave. Kjo sjell shtyrje te afateve per lirimin e brezit te frekuencave, pra duhet te evidentohet ne nje nen te vecante.	Digitalb &ADTN		nenin 9 per periudhen qe do ti duhet operatorev e per te perfunduar procesin e lirimit te DD2 dhe qe do jete jo me vone sesa 6 muaj nga hyrja ne fuqi e ketij ligji.
9.	Komente në lidhje me kostot e komunikimit.	Neni 6: Kostot e komunikimit duhen dakordësuar, pasi do të zënë një vend të rëndësishëm në transmetimet tona.	Top Channel & Digitalb	I pranuar pjesërisht	Shuma totale e kostove te komunikimit eshte vleresuar nga konsulenti në shumën 84,000 Euro. Kjo pjesë do te mbulohet nga AMA dhe nuk pritet të ketë kosto shumë të larta siç pretendojn

					ë operatorët.
10.	Komente ne lidhje me Lidhjen 1 të projekt ligjit	Lidhja 1: Bashkdelidhur lidhjes 1 nuk ka asnje dokumentacion shoqërues dhe normalisht kompensimi duhet te behet ne menyre objective, ne perputhje me kostot reale.	Top Channel & Digitalb &ADTN	I pranuar	Lidhja 1 do te vendoset me vlerat e reja te rivleresimit se bashku me nje shpjegim te shkurtermbasi u be nje rivlersim ne periudhen Janar - Shkurt 2026 nga AMA.
11.	Komente nw lidhje me pajisjet qw do zwvendwsohen.	Lidhja 2 : Pajisjet tona jane te prodhurara dhe te konfiguruara ne menyre te tille qe nese fiken apo hiqen nga përdorimi nuk mund të riperdoren sërish kështu që dalin jashtë funksioni.	Top Channel & Digitalb &ADTN	I pranuar	Gjatë procesit të rivlerësimit konsulentika marre parasysh mungesën e një tregu funksional për pajisje të përdorura (second-hand).